



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIK A KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	316/19
Nr. i Sq. / Br. st.	-13-
Data: / Datum:	27. 11. 2019
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -IX- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 TETOR 2019**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:  
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fitim Halili, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Rrezarta Krasniqi, Hysni Gërguri, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latif, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Selim Rrustemi Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënqryetari i komunës -z. Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe përmarije të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –shprehu shqetësimin e tij lidhur me projektin e kryçjeve individuale në rrjetin e ujësjellësit, përsic tha ai në saje të një marrëveshjeje në mes të komunës, përkatesisht kryetarit të komunës dhe drejtorit të DSHP-së si dhe kryetarit të Këshillit të Fshatit Stanoc, për inkasimin e mjeteve financiare në vlerë prej 80 € në formë të participimit për kryçje në rrjet. Sipas tij, marrëveshja përcaktonte se ai fshat që ka participim më të lartë, do të ketë prioritet në fillimin e kryçjes së rrjetit të ujësjellësit, gjë që kjo në praktikë nuk ka ndodhur. Në këtë kontekst është e çuditshme se si kryçja ka filluar në disa fshatra ku ende nuk ka filluar grumbullimi i mjeteve financiare për participim për kryçje në rrjet. Andaj në këtë rrafsh vlerësoi se një qasje e tillë e kryetarit të komunës është e papranueshme, sepse kemi të bëjmë me një premtim të pa mbajtur të tij, dhe kjo qaje duhet të rishikohet dhe të kemi respektim të marrëveshjeve. Çështje tjetër të cilën ai e adresoi është kontrata e lidhur me një kompani dhe komunës për bartjen e nxënësve në fshatin Gracë dhe Stanoc i Epërm nga muaji shtator. Kjo kompani e quajtur "Andi" ka fituar tenderin për bartjen e nxënësve nga fshati Gracë dhe Stanoc i Epërm deri në shkollën fillore "Migjeni". Kjo kompani nuk është duke i bartur nxënësit përfaktin se prindërit e nxënësve po refuzojnë që fëmijët e tyre t'i bart personi përgjegjës i asaj

kompanie, pasi që ai është në një moshë të shtyrë dhe i njëjti ka pasur disa aksident me fatalitet dhe kështu prindërit vlerësojnë se është rrezik bartja e fëmijëve nga ai person. Për këtë shërbim që qytetari në fakt nuk e merr, komuna paguan mjete financiare, ndërsa të njëtin shërbim të bartjes së nxënësve e kryen një tjetër operator privat dhe prindërit për këtë obligohen të paguajnë. Në këtë formë kemi dëmitim të dyanshëm edhe të buxhetit të komunës e edhe të buxhetit familjar. Ai propozoi që të ngritët një komision që kjo çështje të adresohet dhe të zgjidhet, ku bartës të procesit të zgjidhjes së kësaj problematike duhet të jetë kryetari i komunës dhe Drejtoria e Arsimit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –kërkoi që një rruge apo një sheshi të komunës sonë ti vihet emri i Zeqir Gubetinit babait të Nuredin Gubetinit, i cili ishte pushkatuar në Istog nga armiku serb. Po ashtu propozoi që edhe Smajl Gubetini meriton të lartësohet emri i tij në ndonjë rrugë apo shesh, pasi ai ka luftuar për Shqipërinë dhe është vrarë në vitin 1947 së bashku me Ukshin Kovaçicën.

**Melihate Basholli-Latifî, anëtare e kuvendit-gjithashtu** adresoi problemin e kyçeve individuale në rrjetin e ujësjellësit, proces ky i cili nuk është duke u bërë konform marrëveshjes së komunës dhe këshillave të fshatrave, dhe në kundërshtim me qëndrimet dhe deklarimet e zyrtarëve të lartë dhe udhëheqësve komunal. Andaj konstataoi se veprimet e tillë të kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale janë dekurajim ndaj qytetarëve të përgjegjshëm dhe që i kryejnë obligimet ndaj shtetit dhe në të kundërtën e kësaj është inkurajim i atyre që nuk i kryejnë obligimet ndaj shtetit dhe respektimin e marrëveshjeve të ndryshme. Në këtë kontekst kërkoi nga kryetari dhe qeveria komunale që punimet në ujësjellës të vazhdojnë sipas marrëveshjes mes komunës dhe këshillave të fshatrave, dhe sipas pagesave që janë kryer.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-adresoi** shqetësimin e banorëve të fshatit Sfaraçak, lidhur me nxënësit e këtij fshati që vijojnë mësimet në shkollën e fshatit Nedakoc, të cilët po rrezikohen gjatë kalimit të rrugës, magjistrale Mitrovicë – Prishtinë, ku vetëm në javën e fundit tre fëmijë janë rrezikuar për tu goditë nga veturat. Andaj shtoi se gjatë vitit të kaluar, patrulla policore ka qenë e vendosur në atë vendkalim, por tanë prej se ka filluar ky vit shkollar aty policia nuk del dhe rreziku është shumë i madh për aksident me fatalitet. Në këtë kontekst, kërkoi nga komuna dhe autoritetet përgjegjëse që kjo patrullë policore të jetë në vendin e ngjarjes gjatë ndërrimit të orarit të mësimit atëherë kur nxënësit kalojnë vendkalimin në rrugën magjistrale.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së-lidhur** me shqetësimin për bartjen e nxënësve të fshatit Gracë dhe Stanoc i Epërm, njoftoi se Drejtoria e Arsimit, ka iniciuar nënshkrimin e kontratës për bartjen e nxënësve, konform Ligjit për Transportin e Nxënësve duke zhvilluar aktivitetin e prokurimit në Drejtoren gjegjëse të Prokurimit bazuar në legjisacionin në fuqi në këtë fushë i ka zhvilluar procedurat ligjore deri në përzgjedhjen e operatorit ekonomik, që sipas tyre i ka plotësuar kushtet në mënyrën më të mirë. Pasi ka filluar punën ky operator ekonomik, kanë filluar ankesat e prindërvë për këtë kompani që kjo e fundit të largohet dhe të zëvendësohet më një kompani tjetër. Lidhur me këtë çështje ai kishte pritur në zyrën e tij një grup prindërish për ti dëgjuar ankesat e tyre, dhe se për këto ankesa e ka njoftuar Drejtoren e Prokurimi gjë që sipas tyre është gjithçka në rregull. Pastaj është njoftuar edhe Drejtoria e Inspektiveve, që zyrtari i komunikacionit të inspektoj këtë kompani, dhe sipas vlerësimeve të tyre del se ligjërisht është çdo gjë në rregull, ndërsa personi tjetër që në marrëveshje me prindërit i bartë nxënësit nuk ka kurrfarë leje dhe autorizimi për zhvillimin e një aktivitetit të tillë.

**Refik Maloku, drejtor i DSHP-së-tha** se në takimin e bordit të drejtoreve është marrë vendim që për kyjet individuale të familjeve në rrjetin e ujësjellësit të angazhohen disa ekipe si në pjesën perëndimore të komunës ashtu edhe në pjesën lindore, por edhe në rajonin e shalës. Kjo është kështu, ndërsa nuk ka pasur marrëveshje, për siç thuhet ai që i grumbullon i pari paratë të filloj me prioritet kyçjen në ujësjellës.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtar e kuvendit-vlerësoi** se nuk ka dëgjuar informacione në qytet për caktimin e prioriteteve për kyçje në rrjet, por informata është zyrtare nga takimet e zyrtarëve komunal me këshillat e fshatrave, dhe tani po del në pah se bordi i drejtorëve të komunës nuk i ka respektuar qëndrimet e qytetarëve të bëra në takimet publike që i kanë mbajtur. Ndër të tjera pyeti drejtorin e Arsimit, se shkolla SH.M.U 2 kur do të furnizohet me lëndë djegëse pasi që tani pas keqësimit të moti nuk ka kushte për mbajtjen e mësimit si pasoj e të ftohit.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së-njoftoi** se furnizimi me lëndë djegëse i shkollave do të bëhet shumë shpejt.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** -tha se ato çka i potencoi drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nuk janë të sakta apo thënë ndryshe janë të paqëndrueshme, kjo për faktin se në takime me qytetarë dhe me këshillin e fshatit Stanoc i Epërm, por edhe me kryetarin e komunës janë përcaktuar kriteret për fillimin e procesit të kyçjes në rrjetin e ujësjellësit siç janë nevojat imediatet të banorëve për ujë të pijshëm, pastaj madhësia e fshatit si dhe çështja e shumës të participimit të qytetarëve për kyçje në rrjet. Në këtë relacion nuk ka pasur kurrfarë strategje të punës dhe nëse nuk ka qenë vlerë grumbullimi i mjeteve financiare për participim të qytetarëve atëherë pse është kërkuar nga kryetarët e këshillave të fshatrave që të bëhet grumbullimi i këtyre mjeteve, por të lihet kjo punë kur qytetarët ti kanë mundësit e tyre. Andaj në këtë rrafsh edhe njëherë kërkoi nga komuna që të respektohet marrëveshja që ka të bëj me participimin dhe ky proces të përbyllet sa më shpejt në fshatin Stanoc i Epërm. Lidhur me bartjen e nxënësve përsërit se kompania e kontraktuar shkon me rregull për të marr nxënësit por ata nuk udhëtojnë me këtë kompani, andaj kërkoi që me gjaktohtësi të gjendet një zgjidhje.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-** kërkoi nga kryesuesi i kuvendit, që të respektohet rregullorja e punës së kuvendit, dhe që kuvendi të mos merret siç ai tha me politikat e mahallave, por të merret me politikat që ja përcakton ligji në fuqi.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-në** rekapitullimin e debatit për rendin e ditës njoftoi se pika e nëntë Projekt-strategjia për kujdesin parësor shëndetësor 2020-2024, është kërkuar të hiqet nga rendi i ditës pas kërkësë së bërë nga AQF-ja, ndërsa ndër të tjera paraqiti tri pika shtesë për futej në rend të ditës në pikën në ndryshme.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha** se edhe pse nuk është praktikë e mirë, megjithatë i përkrah pika në të ndryshme pasi që ato kanë një interes të përgjithshëm. Lidhur me pikën për dhënën e pronës komunale në shfrytëzim vendim i cili ishte marrë më herët e cili ishte vlerësuar si jo ligjor nga ministria, shtoi se ai nuk sheh ndonjë ndryshim sa i përket propozimit të ri të dërguar në këtë mbledhje. Për pikën që ka të bëj me shpalljen e interesit të përgjithshëm, potencoi se nuk është që kjo pikë të futet në rend të ditës, pasi që ajo nuk ka ndonjë urgjencë, për faktin se siç dihet në buxhetin e komunës për vitin 2020 nuk është para parë ndërtimit i ndonjë objekti për arsim, kulturë apo shëndetësi si dhe arsyetimi i këtij propozimi nga ana e drejtorisë është tepër i varfër. Andaj ai kërkoi nga anëtaret e kuvendit që njëzëri ta përkrahin propozimin e tij për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës, me qëllim që kjo pikë të analizohet mirë nga zyra ligjore ashtu që mos të ngutemi në marrjen e vendimeve të cilat më vonë po kontestohen nga MAPL-ja, siç po ndodh në vazhdimësi. Me qëllim të ruajtjes së imazhit të këtij kuvendi dhe të përbërjes së tij ashtu që ky kuvend mos ti prij listës së kuvendeve që aprovojnë akte të kundërligjshme, ftoj që anëtaret e kuvend të votojnë për shtyrjen e kësaj pike propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm në ndonjëren nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-fillimisht** kërkoi mirëkuptimin e kuvendit, për vonesat në dërgimin e materialeve për pikat e rendit të ditës, dhe me tej sqaroi se pika që ka të bëj me propozim-vendimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e peshkut, është kthyer nga MAPL-ja, vendim i cili është kontestuar në pjesën e

preambulës së vendimit në thirrjen juridike, kurse në përmbajtje ky akt është i njëjtë. Pastaj sqaroi se ministria e linjës, aktin në fjalë e ka kontestuar se akti është bazuar në nenin 11 të Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, mirëpo nuk është i mbështetur thirrur në pikën 3.1 dhe 3.2 të po të njëjtë ligji në cilat thuhet citojmë:

- 3.1 në rastet kur vlera e investimit është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës të vitit paraprak, por jo me shumë se vlera minimale e përcaktuar me Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës;
- 3.2. në rastet kur një investitor ka shprehur interesim për hapjen e një biznesi në interes të komunës;
- 3.3. në rastet kur nuk ka interesim për marrjen e pronës së komunës në shfrytëzim nga palët për së paku tre (3) vitet e fundit.

Andaj nga të cekurat më lart ministria, kërkon nga komuna që ta rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj atë konform dispozitave ligjore të sipër cekura.

Në fund ai kërkoi nga kuvendi që kjo pikë të futet në rend të ditës dhe e njëjta të aprovohet sipas kërkësë dhe vlerësimeve të dhëna nga MAPL-ja. Lidhur me propozim-vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm, njoftoi se kjo pronë e cila do të shpallet interes i përgjithshëm ndodhet afér objektit të ish –Hotel Vicianumit, dhe për këtë pronë, Komuna e Vushtrrisë është e interesuar që ta shpall si zonë me interes të përgjithshëm.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-duke ju referuar arsyetimit të propozim-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm, ku thuhet se për të paraqitur kërkësë Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta bartur këtë pronën në pronësi të komunës është e nevojshme që kjo pronë të shpallet me interes të përgjithshme, për këtë ai kërko sqarime se bëhet si zhvillohet një procedurë e tillë. Ai vlerësoi se kjo çështje duhet të analizohet, sepse ekziston dyshimi se kjo pronë ndoshta është shpallur më herët zonë me interes të përgjithshëm.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP**-tha se është e vërtet që ka vonesa në shpalljen e kësaj zone me interes të përgjithshëm, dhe shtoi se aprovimi i këtij vendimi i parandalon veprimet e subjekteve tjera që ndikojnë në këtë pronë qoftë nga ministra apo ndonjë subjekt tjetër.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se sa i përket propozim-vendimit për shpalljen e kësaj prone me interes të përgjithshëm, ceku se e përkrahin në tërsi, për faktin se kjo pronë është në interes për qytetaret dhe se sa më shpejt që të bëhet është më mirë për Komunën e Vushtrrisë. Nxjerra e këtij vendimi ndikon në pasurimin kapital të komunës, dhe është nisma fillestare që komuna të kërkoi nga Qeveria e Kosovës që kjo pronë të kthehet në pronësi të komunës. Lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim në Zonën Kadastrale në Gracë të aprovuar në mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit, ceku se vlerësimet e drejtorit të Drejtorisë së Pronës, nuk janë të sakta dhe se ai ose nuk i kuption si duhet faktet e deklaruar nga ministria ose dëshiron që ato ti shtrembëroj. Kjo është kështu përfaktin se ai në takime jo zyrtare kishte deklaruar se prona e cekur nuk ishte dhënë në shfrytëzim konform procedurave ligjore, për arsy se sipas nenit 5 paragrafi 1.2 të Ligjit për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim thuhet se: qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme e komunës duhet të jetë e harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor. Në këtë rast Komuna e Vushtrrisë e ka të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal dhe në bazë të këtij dokumenti kjo pronë është me destinim bujqësor, ndërsa tani prona është dhënë në shfrytëzim për ndërtim, mirëpo ata si grup kuvendar e kanë përkrahur këtë vendim me qëllim që mos të dalin si pengës për realizimin e këtij investimi dhe atë nuk do ta pengojnë as në të ardhmen. Po ashtu me këtë vendim nuk është respektuar pika 2 e nenit 8 e Ligjit për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim në të cilën thuhet: nuk mund të zhvillohet asnjë procedurë e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme pa u plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, pastaj paragrafi 3 i nenit 8 të këtij ligji thotë: Prona e cila do

të jepet në shfrytëzim duhet të jetë pjesë e listës së publikuar për pronat e paluajtshme, ashtu siç është përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji. Ndërsa nen 13 i po të njëjtë ligj përcakton se: Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetur interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës. Të gjitha këto rregulla dhe parime të mishëruara në ligjin e potencuar, kanë për qëllim normimin e situatave për mbrojtjen e konkurrencës së lirë të tregut, e të cilat në rastin konkret janë shkelur, për të cilat ai vlerëson se duhet të renovohen e që të bëhet i mundur realizimi i projekti nga investitori.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –kërkoi që të bëhen sqarime lidhur me sipërfaqen e pronës e cila do të jepet në shfrytëzim për faktin se në mbledhjen e jashtëzakonshme është vendosur që investorit ti jepet në shfrytëzim  $53693\text{ m}^2$  ndërsa tani propozimi është që nga  $53693\text{ m}^2$  ti jepen në shfrytëzim  $30000\text{ m}^2$  për këtë ai kërkoi që këto çështje të sqarohen para se një vendim i tillë të aprovohet.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-tha** se aprovimi i vendimet për dhënien e pronës në shfrytëzim në zonën kadastrale Gracë, duhet të bëhet konform ndryshimeve që janë aprovuar në mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit të datës 16.10.2019, me përjashtim që në bazën ligjore duhet të inkorporohen pika 3.1 dhe 3.2 e nenit 11 të Ligjit për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim. Pastaj lidhur me shqetësimet tjera për shkelje ligjore ai u përgjigj se ministria kompetente i cekur ato nga e zeza në të bardhë si ai e quajti dhe se ne tani nuk mund të shpikim diçka tjetër. Lidhur me publikimin e pronave ai u zotua se lista e pronave komunale është e publikuar në faqen zyrtare të komunës dhe në të mund të kenë qasje çdo anëtar i kuvendit por edhe secili qytetar.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** –pyeti se vendimi i cili do të nxirret sot a e shfuqizon në tërësi vendimin me Nr.279/19 të datës 16.10.2019?

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** –kërkoi që të zhvillohet debati për rendin e ditës dhe mos të diskutohet për përbajtjen e pikave pa ardhur radha e shqyrtimit të atyre temave apo pikave të rendit të ditës.

**Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit** – pyeti se përse në këtë propozim –vendim nuk janë përfshirë ndryshimet e propozuara në mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit të datës 16.10.2019.

**Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor**-paraqiti sqarime lidhur me çështjen në fjalë, duke shtuar se vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim për projektin “ndërtimi i fabrikës për përpunimin e peshkut” i është dërguar ministrisë gjegjëse për vlerësim të ligjshmërisë. Kjo e fundit ka gjetur se vendimi nuk është në harmoni me Ligjin për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, dhe i ka kërkuar komunës përkatesisht kuvendit të komunës që ta bëj harmonizimin e këtij vendimi me legjislacionin në fuqi. Andaj sqaroi se asnjë ndryshim nuk do të bëhet me aprovimin e këtij vendimi përpos që në preambulën e vendimit duhet të ceket në bazë të nenit 11 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 ku përcaktohen format e negocimit të kryetarit të komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit**-tha se grupi kuvendar i LVV-së do ti përkrah pikat shtesë të rendi të ditës me kusht që herëve tjera mos të sillen në kuvend pika të cilat nuk kanë kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

*Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës kuvendit pas votimit me 33 vota “për” I votë “abstenim” aprovoi këtë:*

**R E N D     D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 26.9.2019;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, i datës 16.10.2019;
3. Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2019 për të hyrat dhe shpenzimet;
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020 (**shqyrtimi i parë**);
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr.57/18 i datës 22.02.2018;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me nivelin e pastërtisë dhe eliminimin e deponive ilegale në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
9. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme;
  - b). Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale Nr.278/15 e datës 30.12.2015;
  - c). Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.279/19 i datës 16.10.2019 lidhur me dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 26.9.2019;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 26.9.2019.*

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, i datës 16.10.2019;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit, e datës 16.10.2019;*

3. Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2019 për të hyrat dhe shpenzimet;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – ceku se në raport është evidentuar një lëshim teknik, ku thuhet se shpenzimet për këtë vit janë por nuk specifikohet se a janë më të ulëta apo më të larta. Pastaj lidhur me shpenzimet për vizitat jashtë vendit, kërkoi nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të sjell raport me shkrim për personat që kanë marrë pjesë në këto vizita jashtë vendit dhe të jepet arsyetim se çfarë të mirash i kanë sjell Komunës së Vushtrrisë nga këto vizita.

**Lutfi Gërguri, drektor i DBF-së-tha** se shpenzimet janë më larta se sa vitin e kaluar, ndërsa për sa i takon vizitave jashtë vendit nuk i posedon shënimet, por se ato shënime mund të nxirren dhe të ofrohet raporti para kuvendit.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se bazuar në planifikimin financiar shumica e drejtoreve komunale kanë deficit në realizimin e inkasimit sipas planifikimit për këtë periudhë raportuese. Andaj pyeti se pse po ndodh një gjë e tillë, ndërsa realizimi i shpenzimeve tek investimet

kapitale është shumë i ulët, deri në këtë muaj në masën më pak se 30 % dhe kjo është një shifër shumë e varfër. Pastaj pyeti se çka nënkuption termi shpenzime të vogla para xhepi për çfarë lloj shpenzimesh bëhet fjalë, shërbimet e ndryshme kontraktuese, kërkoi sqarime se për çfarë shërbimesh kontraktuese bëhet fjalë ku shuma e tyre është afër 300 mi euro. Shpenzimet për karburante janë pothuajse të njëjtë me atë të vit 2018 me një dallim të vogël për më pak se 100 €, për këtë pyeti se a kemi të bëjmë me shpenzim për atë se shpenzohen gjithherë të njëjtat litra të naftës apo çka është në pyetje në këtë rast. Tutej tek shpenzimi avancë për para të imta në vitin 2018 nuk kemi fare shpenzime, kurse në vitin 2019 kemi 2,900 €, për këtë pyeti se çka nënkupton ky terem. Lidhur me shpenzimet nga vendimet e gjykatave në vitin 2018 kemi 30,263.35 € kurse në vitin 2019 kemi 62,614.07€ për këtë pyeti se në cilat raste i ka humbur këto para komuna.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-tha** se kur bëhet fjalë për inkasimin e të hyrave vetanake, tavanin e tyre e cakton Ministra e Financave, andaj planifikimi i të hyrave bëhet konform kritereve dhe kornizave të përcaktuara nga ana e kësaj ministrie. Ai njoftoi se përcaktimet e ministrisë lidhur me tavanin e të hyrave është gjithherë mi lartë se sa që komuna ka mundësi që ta realizoj. Në këtë kontekst shtoi se këtë vit kemi realizim të të hyrave vetanake më shumë se sa viti i kaluar për 40.56 %. Lidhur me shpenzimet në investimet kapitale, dihet fakti se shumica e punimeve kryhet gjatë tre majorit të fundit të vitit dhe se pas përfundimit të këtyre punimeve bëhen pagesat dhe kjo e rrit nivelin e realizimit të buxhetit në shpenzime si i përket kategorisë së kapitaleve. Shpenzimi i parave të gjepit nënkuption peti-kesh të cilat shfrytëzohen nga arsimi, shëndetësia dhe administrata, shpenzimet kontraktuese të cilat janë më të larta se sa nga vit i kaluar kjo është bërë për faktin se është filluar me pagesën ndaj Kompanisë “Uniteti” vlerën prej 39,000.00 € por këtu bënë pjesë edhe transporti i nxënësve. Avancë për paratë e imta janë shpenzime që bëhen gjatë vizitave në vendet e jashtëm të një pjese të mjeteve financiare të cilat duhet të arsyetoohen nga personat zyrtar. Ndërsa shpenzimet e gjykatave janë kryesishët për pagat jubilare në arsim.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-kërkoi** që të merret një vendim për ndarjen e mbushjeve telefonike për anëtaret e kuvendi në vlerë prej 10 € për secilin anëtar.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Raportin janar-shtator 2019 për të hyrat dhe shpenzimet.**

**4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020 (shqyrtimi i parë);**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –kërkoi** që normat e interesit sa i përket tatimit në pronë të ulën deri në minimum ashtu si e përcakton ligji ashtu që tu lehtësojmë sa do pak qytetarëve që të paguajnë më pak tatim, andaj kërkoi që në secilin pozicion të jetë norma minimale e interesit sa i përket pagese së tatimit në pronë.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-tha** se normat e tatimit janë propozuar zbritje nga 0.17 % në 0.15 %, ndërsa nuk është parë e dejtë që për pronat komerciale, të aplikohet norma minimale. Norma aktuale për pronat komerciale është 0.21%

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –kërkoi** që propozimi i për zbritjen e normave tatimore tek pronat komerciale.

**Pas votimit të kuvendi me 7 vota “për” 19 vota “kundër” kuvendi nuk e aprovoi propozimin për uljen e normave tatimore tek pronat komerciale.**

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatim në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020.
2. Diskutimi publik fillon nga data 11 nëntor 2019 dhe zgjat deri më 11 dhjetor 2019.
3. Obligohet Zyra për Komunikim me Publikun që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr.57/18 i datës 22.02.2018;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –tha se kishte me qenë mirë që të jepen informacione për personin që është emëruar Komandant i Stacionit Policor në Vushtrri, një profil të tij lidhur me përgatitjen e tij profesionale dhe veprimit e tij.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit të komunës 01 nr. 57/18, i datës 22.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, përkatësisht neni 1, paragrafi 1.2, në vend të Muhamed Alidemaj do të jetë Reshat Kovaqi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Njësia e Personelit dhe Sekretaria e kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me nivelin e pastërtisë dhe eliminimin e deponive ilegale në Komunën e Vushtrrisë;**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –përsërit problematikën e kamotshme, për gjuajtjen dhe ndotjen mjedisore që po ndodh tash e sa kohë në fushën mes fshatrave Pasomë-Banjskë-Sllatinë, ku hedhen mbeturina të ngurta dhe jo vetëm, që po shkakton ndotej enorme mjedisore. Pastaj vlerësoi se me dhjetëra herë e ka ngritur këtë problematikë por sikur ky problem ka hasur në vesh të shurdhër në organet kompetente komunale. Më tej shtoi se qeveria e kaluar por as kjo qeveri aktuale komunale nuk ka ndërmarr asgjë për të rregulluar këtë problematikë. Shfrytëzimi i një shkëmbi nga një operator ekonomik (gurthyes) dhe bartja e tij me kamion të peshave të rënda vërtet ka shkaktuar problem të shumta, ka shkatërruar rrugën dhe ndotet nga pluhuri i shkëmbit nga gurëthyesi. Përsëriti se kjo problematikë shtron nevojën e intervenimit imediat në parandalimin dhe zgjidhjen e saj. Në fund kerkoi nga Drejtori për Inspektime që të vij në mbledhje të kuvendit të jap sqarime por edhe të ndërmarr masa urgjente për zgjidhjen e këtij problemi.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –tha se jemi të kënaqur më punën që po bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike, në mirëmbajtjen dhe pastërtinë mjedisore, por edhe në grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe në eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave. Tutej vlerësoi se përpos ambientit të jashtëm është mirë të përkujdesemi për pastërtinë e shkollave, pasi që pas furnizimit të shkollave me kifle, në shkollën fillore “Migjeni” në Stanoc të Epërm, ka filluar shfaqja e minjve dhe kjo rrezikon në përhapjen e ndonjë epidemie ku do të pësonin nxënësit-fëmijët tanë. Pastaj vlerësoi se informata që është dhënë nga Drejtoria e Urbanizimit dhe ajo e Shërbimeve Publike kanë disa statistika dhe të dhëna të njëjtë dhe kishte me qenë mirë që kur të hartohen këto informata të kemi koordinim të drejtorive ashtu që këto të dhëna mos të përsëriten.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –tha se ajo çka ka deklaruar në vazhdimesi anëtarë i kuvendit z. Ali Januzi, lidhur me ndotjen mjedisore në fshatin Pasomë është shumë e vërtet. Por e keqja jonë si shoqëri është se ne vetëm i konstatojmë problemet dhe ato mbesin pa u zgjidhur. Kjo është tepër jo serioze dhe për këtë pyeti se komuna a ka të drejt të merret me këtë problematikë, për ta zgjedhur, nëse kemi të drejt atëherë duhet të sillemi serioz si institucionet ashtu që të eliminohen ato deponi mbeturinash, dhe në të kundërtën duhet të informohemi me shkrim që komuna nuk ka të drejt të merret me këtë problem. Tutej ai përgëzoi Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për një menaxhim të mirë të mbeturinave, dhe shtoi se edhe përkundrejt fakti të pajisjes me kontejner mbeturinash, prapëserapaprë po kemi gjuajtje në vende jo adekuate të tyre andaj, kerkoi që në këtë proces të involvohet Drejtoria për Inspektime duke shqiptuar gjoba konform ligjit. Mandje ceku se pengesat të cilat po vendosen në rrugë për uljen e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve nga ana e qytetarëve, nuk është në rregull, sepse ato duhet të bëhen nga organi kompetent siç është Drejtoria e Shërbimeve Publike që ato të bëhen në mënyrë të rregull dhe sipas nevojës.

**Besim Muzaqi, nënkyetari i komunës**-duke ju referuar parafolësve ceku se komuna jo që ka të drejtë por ka edhe obligim, që merret me eliminimin e deponive ilegale, brenda kapaciteteve të saj. Pastaj shtoi se ka pasur shumë iniciativa dhe ndërmarrje tjera qoftë nga niveli qendror në bashkëpunim me komunën për eliminimin e deponive ilegale si ka qenë ndërmarrja “Ta pastrojmë Kosovën” aksion ky që ka rezultuar pozitiv dhe ka ndikuar në ngritjen e nivelit të pastërtisë dhe menaxhimin më cilësor të mjedisit në Komunën e Vushtrrisë. Lidhur me deponinë ilegale të mbeturinave në mes fshatrave Pasomë-Banjskë-Sllatinë, e cila është një deponi shumë

e madhe dhe kjo është tepër shqetësuese edhe për qeverinë komunale. Pastaj njoftoi se në bashkëpunim me Kompaninë "Uniteti" por edhe me kompanitë tjera që janë duke punuar në autostradë kanë kërkuar që ato materiale inerte ti shtyjnë dhe ti mbulojnë. Qeveria komunale është duke përgatitur një planë për të gjetur një metodë e cila do ti bluante këto mbetjet inerte dhe të njëjtat të trajtohen në mënyrë profesionale, ndërsa deponia të eliminohet dhe ajo pjesë të rivitalizohet qoftë duke bërë ripyllëzimin e saj apo duke ndërtuar ndonjë parak. Në fund tha se përkushtimi i komunës nuk mungon për të vepruar për këtë problematik por siç dihet për këtë problem nevojiten fonde ti cilat komunës i mungojnë dhe për këtë kërkoi mirëkuptim.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se e përgëzojmë hartuesin për ofrimin e kësaj informate, dhe deklaroit se gjendja e pastërtisë dhe ajo hidro-sanitare nëpër objektet e institucioneve komunale si: objekti i komunës, qendrat e mjekësisë familjare dhe shkollat nuk është duke u mirëmbajtur sipas legjisacionit në fuqi, andaj për këtë kërkoi informatë me shkrim se a është duke u bërë dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i objekteve ashtu siç është përcaktuar ky obligim ligjor që ky proces të kryet për çdo gjashtë (6) muaj ashtu siç parashihet me ligj, sepse sikur të kishte ndodhur kjo që më herët ka qenë praktikë e komunës që kjo të implementohet DDD-ja, por që tani kjo nuk është duke u respektuar. Në të kundërtën nëse ky proces është kryer atëherë kërkoi që të informohet se cila kompani e ka kryer këtë proces, në cilat objektet (pika) cili ka qenë plani operativ dhe gjitha procedurat tjera të raportohen me shkrim.

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit**-tha se në kuadër të mbrojtjes mjedisore, të inspektohen edhe atë të cilët nuk janë të kyçur në kolektorët kryesor të kanalizimeve për faktin se kemi kundërmim të madh të erërave të rënda. Pastaj në QMF në fshatin Pantinë dhe në AMF-në fshatin Oshlan nuk janë vendosur kontejner, kërkoi që kjo të bëhet.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** –tha se e përgëzon qeverinë komunale për idenë e tyre për hartimin e një plani që ka të bëj me eliminimin e deponisë ilegale në fushën në mes fshatrave Pasomë-Banjskë-Sllatinë. Pastaj propozoi që të ndahet një buxhet për vendosjen e pengesave profesionale –policëve të shtrirë që ato të vendosen sipas standardeve dhe jo që qytetaret sipas dëshirave të tyre ti vendosin ato pengesa.

**Besim Muzaqi, nënkryetari i komunës**-tha se një operator ekonomik ka fituar tenderin për rregullimin e sinjalizimit horizontal dhe vertikal, por edhe për rregullimin e rrugëve dhe vendosjen e pengesave profesionale në rrugë. Ai ftoj qytetaret e komunës që të bashkëpunojnë me qeverinë komunale, dhe aty ku dëshirojnë të intervenoj në ndonjë prerje të rrugëve të bëjnë kërkësë në drejtorinë kompetente komunale, ashtu që ti shmangen shqiptimit të ndonjë gjobe komunale.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;

**Ali Januzi anëtar i kuvendit**- theksoj se do të ishte mirë qe të ishte prezentë ne seancë edhe drejtori i kadastrit për ta informuar kuvendin se ku gjendet ajo parcelë se çfarë lloji i tokës është dhe për çka do të destinohet. Kërkojë nga kadastro që kur ta sjellë materialin le ti emërtojë ato prona krahas numrit që tregon parcelën.

**Nasuf Aliu kryesues i kuvendit**- sqaroi se mbrapa materialit tregohet emri i shfrytëzuesit z. Zenel Zhabari dhe tregoj se do të përdoret për grumbullimin dhe trajtimin e qenve endacak në pronën e tij private dhe kërkohet që nga toka bujqësore ti ndërrohet destinimi kësaj prone në tokë ndërtimore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202044-00402-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë), në sipërfaqe prej  $500m^2$  të marra nga sipërfaqja totale  $3601m^2$ , Zona Kadastrale Novolan, pronë e Zenel (Shahin) Zhabari me vendbanim në fsh. Novolan, Komuna Vushtrri.
2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi është ndërtimi i objektit për grumbullimin dhe trajtimin e qenve.
3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.
4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën ”b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
9. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet interesi i përgjithshëm për ndërtimin e infrastrukturës shkolllore, shëndetësore, kulturore dhe projekte tjera me interes për Komunën e Vushtrrisë në Zonën Kadastrale Vushtrri në pronën e paluajtshme, parcela kadastrale P-70202016-02234-0 me sipërfaqe prej  $21217m^2$ , evidentuar në emër të Ministrisë së Drejtësisë-Shërbimi Korrektues.
2. Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi shërben për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve shkolllore, shëndetësore, kulturore dhe projekte tjera me interes për Komunën e Vushtrrisë.

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen:** Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjëodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

**4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat e pronës dhe ortofotot.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**b).** Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale Nr.278/15 e datës 30.12.2015;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

**1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale nr. 278/15, dt. 30.12.2015.**

**2. Diskutimi publik fillon nga data 11 nëntor 2019 dhe zgjat deri më 25 dhjetor 2019.**

**3. Obligohet Zyra për Komunikim me Publikun që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që si propozues i draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'a prezantojë kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**c).** Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.279/19 i datës 16.10.2019 lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale;

**Albanez Tahiraj zyrtar i lartë ligjore-** pasi që e diskutuan edhe në zyrën ligjore erdhëm në një përfundim që ta shfuqizojmë këtë vendim pasi që është i një natyre tjetër ky vendim që të mos ketë dy akte juridike për të njëjtën çështje, sepse ky vendim do të prodhoj shumë procedura tjera ligjore deri në zbatimin e tij. Hyrja ne fuqi e vendimit të ri do ta shfuqizojë me automatizëm të vjetrin.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 23 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Aprovohet oferta e negociuar nga Kryetari i komunës dhe jepet në shfrytëzim me kompensim parcela kadastrale P-70202022-00512-1, ZK-Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 53693 m<sup>2</sup>.

2. Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin me kompensim, në afat prej 40 vitesh, Kompanisë “Emona” SH. P.K (Emona Group) me seli në Vushtrri, në partneritet me kompaninë kroate “Conex Trade” d.o.o dhe kompaninë spanjolle “Connorosa S.A” për ndërtimin e fabrikës përpunimin e peshkut të detit, si ofertë e përzgjedhur e paraqitur në negociatat e drejtpërdrejta të Kryetarit të komunës.

3. Çmimi vjetor i qirasë është tre qind euro (300 €) për një (1) hektar.

4. Obligohet Kryetari i komunës të lidhë kontratë për dhënien me qira të pronës komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, me ofertuesin e përzgjedhur në negociata të drejtpërdrejta nga Kryetari i komunës.


5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata e pronës, kopja e planit, kërkesa dhe procesverbali nga shqyrtimi i ofertave të drejtpërdrejta nga Kryetari i komunës.

7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. 279/19 i datës 16.10.2019.

8. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:45.

Bastri Duraku  
  
Procesmbajtës

